

SITUATA E PERMBYTJEVE NE VLORE, FIER, BERAT DHE KORCE DHE NEVOJA PER NDERHYRJE —MONITORIMI

SITUATES NGA OBSERVATORI PER TE DREJTAT E FEMIJEVE
Newsletter - Nr 6, 13 Tetor 2015

Ky dokument i referohet të dhënave të mbledhura nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve nga institucionet lokale përkatëse.

Iniciativa për mbledhjen e të dhënave dhe publikimin e këtij dokumenti zhvillohet në zbatim të projektit “Mbështetja e Observatorit në planifikimin e politikave në bazë të të dhënave për fëmijët me fokus ndërhyrjet në nivel vendor”, realizuar në bashkëpunim me **UNICEF në Shqipëri** gjatë periudhës 2015-2016.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Observatorit dhe nuk shpreh domosdoshmërisht opinionin e UNICEF.

©Observatori/Unicef

Për më shumë se 3 ditë Shqipëria po kalon një situatë të vështirë përmytjesh në Jug të Shqipërisë. Për shkak të intensitetit të lartë të reshjeve të shiut, përmytjet kanë qenë një kërcënim për shtëpitë, agrikulturën, blegtorinë edhe për banorët e zonave të prekura. Bazuar në skanimin e situatës që Observatori për të Drejtat e Fëmijëve ka bërë, qarqet e prekura më shumë nga kjo situatë janë Vlorë, Fieri, Berati dhe Korça. Në Vlorë problematikë ka qenë vërshimi i masiveve me dhe, me gurë në aksin Vlorë -Orikum, në hyrje të Vlorës. Gjatë ditës së hënë 12 Tetor 2015, pothuajse uji ka renë në të gjitha zonat problematike duke krijuar një baltë të madhe në rrugë dhe shtëpi. Në Fier përmytjet e shumta kanë ardhur nga dalja nga shtrati e lumit Gjanica. Në Berat situata e përmytjeve është përkeqësuar për shkak të daljes së lumit Osum nga shtrati. Në Korçë përmytjet kanë ardhur nga prurjet e tepërta të inerteve të lumit Gllabishtovë të malit Gramoz, daljes nga shtrati të lumit të Verdoves në qytetin e Pogradecit. Nga reshjet e shiut janë dëmtuar 9 shtëpi banimi në fshatin Podgorie, Bashkia Maliq.

Zonat e prekura më shumë nga përmytjet janë:

Qarku Vlorë:

- Disa lagje brenda në qytetin e Vlorës si Lagja "15 Tetori", "29 Nentori" "10 Korriku",
- Zona e Skelës,
- Lagja Cole,
- Aksi Vlorë -Orikum, në hyrje të Vlorës,
- Novoselë,
- Akerni.

Qarku Fier:

- Pedonalia e qytetit si pasojë e daljes së lumit Gjanica,
- lagja "1 Maji",
- tek ura me shkallë,
- lagja "Kongresi i Përmetit",
- lagja "Liri",
- Sheq i Madh,
- Frakull,
- Libofshë.

Qarku Berat:

- Pedonalja e qytetit,
- zona e ish pyjores tek lagjja "30 vjetori",
- fshati Morave në zonën Otlak,
- Bashkia Urë Vajgurore.

Qarku Korçë:

- Ura e fshatit Psar, rrethi Kolonjë,
- Rruga kombëtare në hyrje të qytetit të Ersekës,
- Bashkia Pogradec,
- Fshati Podgorie, bashkia Maliq.

Numri i familjeve të prekura nga situata e përmbytjeve

Në qarkun Vlorë janë mbi *300 familje*, shtëpitë e të cilave janë përmbytur fare ose uji ka hyrë pak brenda shtëpive të tyre, nga të cilët *10* prej tyre janë akomoduar pranë konviktit të shkollës së mesme Industriale Vlorë. **Në qarkun Fier** ka një numër me përafërsi prej *550 familjesh* që janë prekur nga përmbytjet, nga të cilat *60 familje* janë evakuar në konvikte. **Në qarkun Berat** janë *12 familje* të prekura nga situata e përmbytjeve, nga të cilat asnjë nuk është evakuar. **Në qarkun Korçë** janë *11 familje* të prekura nga situata e përmbytjeve, nga të cilat *1* është evakuar/ akomoduar nga Bashkia Pogradec, ndërsa *10* familjet e tjera janë sistemuar tek të aferm ose kanë rregulluar vetëm një dhomë për të qendruar.

Në total numri i familjeve të prekura nga përmbytjet është *873 familje* të prekura në Jug të Shqipërisë në muajin tetor 2015.

Numri i fëmijëve të prekur nga situata e përmbytjeve

Në qarkun Vlorë janë mbi *100 fëmijë*, familjet e të cilëve janë prekur nga përmbytjet, nga të cilët *15 fëmijë* janë akomoduar në konviktin e shkollës së mesme Industriale Vlorë. **Në qarkun Fier** në 11 Tetor 2015 në lumin Gjanica janë evakuar *5 fëmijë* të disa familjeve që kanë qenë të bllokuar. **Në qarkun Berat** janë *28 fëmijë*, familjet e të cilëve janë prekur nga situata e përmbytjeve.

Numri i fëmijëve të prekur nga situata e përmbytjeve dhe të përfshirë në këtë situatë është mbi *133 fëmijë*.

Ndërhyrjet e Institucioneve lokale

Në zonat e përmbytura janë angazhuar Institucionet lokale për të përballuar këtë emergjencë civile. **Në qarkun Vlorë** u mbledh shtabi i emergjencave. Familjet më problematike janë akomoduar pranë konviktit të shkollës së mesme Industriale Vlorë. Në 11 Tetor 2015 në mëngjes është nisur procesi i pastrimit dhe hapjes së

rrugëve kryesore. Më pas janë evidentuar shtëpitë me problematikë nga përmytja. **Në qarkun Fier** është ngritur Shtabi i Emergjencave, autoritetet vendore dhe ekipet e policisë kanë marrë masat për evakuimin, ekip "Delta Force". **Në qarkun Berat** nga shtabi i Emergjencës në Prefekturë është hequr uji nga banesat. Bashkia Berat po merret me përlogaritjet e dëmeve për t'i ardhur në ndihmë. **Në qarkun Korçë**, për përballimin e kësaj situatë u vunë në lëvizje forcat zjarrfikëse të stacionit të Ersekës si dhe 6 mjete të subjekteve private për pastrimin e rrugës. Për zhbllokimin e njërit aks të rrugës u punua deri në oren 11:30 të datës 11 Tetor 2015 në funksion të hapjes së të gjithë aksit. Në Pogradec, për përballimin e situatës u angazhuan rreth 100 persona të venë në dispozicion nga Bashkia si dhe personeli i stacionit zjarrfikës i rrethit Pogradec. Gjithashtu u përdorën 10 mjete për pastrimin e inerteve, si dhe 5 pompa thithëse për largimin e ujit nga katet e përmytura të godinave shumëkatëshe. Është ngritur Komisioni i Emergjencave në Prefekturë që po bashkëpunon me pushtetin lokal, për të bërë vlerësimin e dëmeve, pra janë në proçes.

Nevojat e identifikuar për ndërhyrje

Ka nevojë për veshmbathje, mobilje, elektoshtëpiake, ushqime etj.

Shënime të tjera

Në qarkun Vlorë pjesë e përmytjeve kanë qenë dhe oborret e disa shkollave. Ditën e hënë 12 tetor 2015 edhe pse uji gjatë natës është larguar në këto shkolla, nuk është bërë mësim për shkak të baltës së madhe të mbetur pas largimit të ujit. Janë rreth 5 shkolla të cilat ditën e hënë, që nuk kanë zhvilluar mësim. **Në qarkun Fier** shtëpitë janë në një gjendje dëmtimi pas përmytjeve masive. **Në qarkun Berat**, ka familje që janë bllokuar nga përmytjet, por jo shtëpi të evakuara. Përsa i përket arsimit asnjë shkollë nuk është e mbyllur. Ndërkohë përsa i përket kolektorëve të ujit ata janë prekur nga përmytjet dhe uji i pijshëm është i pakonsumueshëm nga qytetarët.